



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
SHOQËRITË HUAMARRËSE NË ADMINISTRIM

Nr. 96 Prot.

Tiranë, më 28 / 05 / 2026

NJOFTIM PËR RISHHPALLJE TË POZICIONIT VAKANT

Pozicioni: Roje Objekti

Institucioni ynë njofton rishpalljen e pozicionit vakant “Roje Objekti”, për shkak se në procedurën e mëparshme të aplikimit nuk u përzgjedh asnjë kandidat fitues.

Pozicioni shpallet me qëllim garantimin e sigurisë, ruajtjes dhe mbarëvajtjes së aktivitetit në ambientet institucionale.

Përshkrimi i përgjithshëm i detyrës

Roja e objektit është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e ambienteve të institucionit, kontrollin e hyrje-daljeve të personave dhe mjeteve, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të perimetrit të objektit. Gjithashtu, siguron zbatimin e rregullave të brendshme dhe raporton në kohë çdo situatë të pazakontë apo incident.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Kontrollon hyrje-daljet në objekt dhe verifikon identitetin e vizitorëve;
- Kryen patrullime periodike për garantimin e sigurisë fizike të ambienteve;
- Reagon menjëherë ndaj situatave emergjente dhe njofton strukturat përkatëse;
- Mban regjistrat e hyrje-daljeve dhe raporton çdo parregullsi të konstatuar;
- Zbaton me korrektësi rregulloret dhe procedurat e sigurisë së institucionit.

Kriteret e kërkuara

- Arsim i mesëm i ulët (9-vjeçar); preferohet trajnim në fushën e sigurisë;
- Eksperienca e mëparshme në pozicione të ngjashme përbën avantazh;
- Aftësi të mira komunikimi dhe përgjegjshmëri në punë;
- Integritet dhe korrektësi e lartë profesionale;
- Gatishmëri për të punuar me turne.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Dokumentacioni i kërkuar

- Kërkesë për aplikim;
- Curriculum Vitae (CV);
- Fotokopje e kartës së identitetit;
- Kopje e diplomës/dëftesës;
- Dëshmi penaliteti;
- Raport mjekësor i aftë për punë;
- Dokumente që vërtetojnë eksperiencën e punës (nëse ka).

Afati i aplikimit

Aplikimet pranoen deri më datë 08 / 06 / 2026.

Mënyra e aplikimit

Të interesuarit mund të dorëzojnë dokumentacionin pranë zyrave të institucionit ose në adresën elektronike:

liridon.cela@shha.gov.al

ADMINISTRATORI

Arben Preqja

